$V_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{maxk1}$  \_\_\_\_\_ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$O_{k1}$  \_\_\_\_\_ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

### **Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:**

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

### **21. Konvertimi në valutë të vetme**

**22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht te ulët**

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

#### **D. DHËNIA E KONTRATËS**

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
  2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
  - b) garanci bankare;
  - c) garanci nga shoqëri sigurimi.



## DH. ANKESAT

### 25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## E. ANULIMI I PROCEDURËS

### 26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

---

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>4</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

**Kujdes:** Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

**Shtojca 3.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					



---

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Përfaqësuesi i Ofertuesit

### Nënshkrimi

### Vula

**Shtojca 6.**

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE****LOTI 1 – BLERJE MATERIALE KANCELARIE ME BAZË LETRE**

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm pa logo	Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti aktual.	copë
2	Axhendë ditore afërsisht 17.2x24 cm, me logo	Axhenda ditore të ketë përmasat 17.2x24 cm (deri në 5% marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, ngjyra të ndryshme, të shkruhet viti aktual, me logo. Të jepen përmasat e logos dhe fotoja me ngjyra, dhe kjo e fundit të përcillet në formatin vektorial vetëm tek OE fitues.	copë
3	Bexho PVC me clip metalik	Bexho PVC me clip metalik dhe me kapëse. Materiali i bexhos të jetë plastik i fortë.	copë
4	Blllok A4 me kapak, imitacion lëkure	Blllok në format A4 me kapak, imitacion lëkure. Të jetë format A4 me vija ose katrore, të jetë me ngjitje, me kapak imitacion lëkure, ngjyrë gri/e zezë/blu, të ketë 100/120 fletë.	copë
5	Blllok A4 kapak i fortë me 96 fletë	Blllok format A4, me letër me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, minimumi 96 fletë.	copë
6	Blllok A4 kapak i fortë me 168 fletë	Blllok format A4, me letër me vija ose kuadrate, kapak i fortë kartoni ngjyra të ndryshme, min 168 fletë.	copë
7	Blllok shënimesh A5 me 60 fletë	Blllok format A5, me letër me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, minimumi 60 fletë me lidhje spirale.	copë
8	Blllok A5 imitacion lëkure me 100 fletë	Blllok A5, kapak i fortë imitacion lëkure ngjyra të ndryshme, të ketë minimumi 100 fletë.	copë
9	Blllok shënimesh me material adeziv 75x127 mm	Blllok shënimesh, material adeziv, përmasa 75x127 me ngjitje, (deri në 5% marzh gabimi).	copë
10	Blllok shënimesh me material adesiv 75 x 75 mm	Blllok shënimesh, materail adesiv, përmasa 75 x 75 mm, (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
11	Çanta kartoni për dhurata, 26x32 cm	Çanta kartoni njëngjyrëshe me dorezë litari për dhurata të përmasave 26x32 cm, kartoni të jetë i fortë (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
12	Çanta kartoni për dhurata, 30x40 cm	Çanta kartoni një ngjyrëshe me dorezë litari për dhurata të përmasave 30x40 cm, kartoni të jetë i fortë me marzh gabimi 5%.	copë
13	Çanta kartoni për shishe vere, 15x45 cm	Çanta kartoni nje ngjyrëshe me dorezë litari për dhurata për shishe verë me përmasa 15x45 cm, kartoni të jetë i fortë (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
14	Dosje firme pa logo	Të jetë me imitacion lëkure, format A4. Të ketë deri në 30 ndarëse për vendosjen e dokumentave A4.	copë
15	Dosje me mekanizëm, 7cm	Dosje me mekanizëm A4, me kuti, përmasa 28x35x7 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.	copë
16	Dosje me mekanizëm, 5 cm	Dosje me mekanizëm të jetë prej materiali plastik, me trashësi 5 cm, përmasa afërsisht 31x29x5 cm (deri ne 5% marzh gabimi), të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.	copë
17	Dosje me mekanizëm, 7 cm	Dosje me mekanizëm, material karton i plastifikuar, me trashësi 7 cm. Të ketë të montuar bazamentin metalik për fiksimin e	copë

		dokumenteve. Me ngjyra të ndryshme. Gjithashtu, të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse.	
18	Dosje me 2 unaza, 2.5 cm	Format A4, materiali karton me mbështjellje te celetonuar, të jetë me 2 unaza. Gjerësia e dosjes të jetë 2.5 cm. (deri ne 5% marzh gabimi)	copë
19	Dosje plastike (e plastifikuar) me llastik, 3 cm	Dosje plastike me llastik, trashësia të jetë 3 cm, format A4, të ketë nga brenda kapak për fiksimin e materialeve dhe të mbyllet me llastik, me ngjyra të ndryshme.	copë
20	Dosje kartoni e thjeshtë	Të jetë material kartoni, përmasa 25x34 cm, me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave), gjerësia 9 cm, (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
21	Dosje arkive kartoni me buton 6 cm	Të jetë karton i trashë, të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të kete kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 35x24.5x6 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.	copë
22	Dosje arkive kartoni me buton 10 cm	Të jetë material me trashësi 1.1 mm, të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 34x24x10 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.	copë
23	Dosje arkive kartoni buton 12 cm	Të jetë material kartoni, të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të jetë me veshë në anësore për mbajtjen e dokumentave. Përmasa 24.5x35x12cm (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
24	Dosje arkive kartoni buton 15 cm	Të jetë material me trashësi 1.1 mm, të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të ketë kapak fiksues me precina për fiksimin e materialeve në të dy krahët anësore, të jetë me përmasa 34x24x15 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme.	copë
25	Dosje kartoni me llastik	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave). Te mbyllet me llastik. Përmasat 24x34cm (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
26	Dosje kartoni me llastik 2 cm	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik të trashë për mbyllje, të ketë nga brenda veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) Përmasa 25x34.5x2cm (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
27	Dosje kartoni me llastik 5cm	Dosja të jetë material kartoni, me llustër nga jashtë, të jetë me llastik të trashë. Trashësia e llastikut 1.2cm, të jetë nga brenda me veshë në anësore, 2 copë lart/poshtë për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa e dosjes 25x34.5x 5 (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
28	Dosje konference me kapse të fortë pa logo	Dosje konference. E lehtë për t'u transportuar, përdoret për mbajtjen e materialeve të leksioneve apo fjalimeve të konferencave. Format A4.	copë
29	Dosje konference me kapak imitacion lëkure me xhep me logo	Kapaku të jetë me imitacion lëkure, format A4, të ketë xhep të brendshëm për mbajtjen e dokumentave dhe të ketë te stampuar logon e AK-së. Të jepen përmasat e logos dhe fotoja me ngjyra, dhe kjo e fundit të përcillet në formatin vektorial vetëm tek OE fitues.	copë
30	Dosje konference kapak imitacion lëkure me xhep pa logo	Kapaku të jetë me imitacion lëkure, format A4, të ketë xhep të brendshëm për mbajtjen e dokumentave.	copë
31	Dosje me 10 zarfa plastik	Të jetë me 10 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4.Zarfat plastikë duhet të jenë të integruar në 10 ndarje në pjesën e brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 mic	copë
32	Dosje me 30 zarfa plastik	Të jetë me 30 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4.Zarfat plastikë duhet të jenë të integruar në 30 ndarje në pjesën e brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 mic	copë
33	Dosje me 50 zarfa plastik	Të jetë me 50 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4.Zarfat plastikë duhet të jenë të integruar në 50 ndarje në pjesën e	copë

		brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfit të brendshëm 35-40 mic	
34	Dosje me 80 zarfa plastik	Të jetë me 50 zarfa plastike për mbajtje dokumentash në format A4. Zarfat plastikë duhet të jenë të integruar në 80 ndarje në pjesën e brendshme. Zarfat të jenë të tejdukshëm që të mundësojnë lexueshmëri të dokumentave. Trashësia e zarfave të brendshëm 35-40 mic	copë
35	Dosje me buton 8 cm kartoni	Dosje kartoni për arkiv me buton, të jetë material kartoni, të ketë kapëse (perçine) për mbylljen e dosjes, në brendësi të jetë me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave) për fiksimin e materialeve. Përmasa 24.5x35x8cm (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
36	Dosje personeli	Dosje personeli, materiali PVC, ngjyra të ndryshme, me kapse metalike të brendshme, përmasat e dosjes 32 x 24 x 2 cm. Në pamjen ballore (kapakun e dosjes) të jetë e stampuar: Stema e Republikës së Shqipërisë, emri i institucionit përkatës sipas kërkesës, me madhësi shkrimi 12 dhe gërma kapitale. Në qendër të dosjes të shkruhet: Dosje Personeli (me madhësi shkrimi 14 dhe gërma kapitale). Në pjesën e poshtme të shkruhet nr. dosjes dhe në fund Emër, Atësia, Mbiemër. Dosja të mbyllet me dy llastiqe anësore në krahun e djathtë të saj. Në krahun e majtë të dosjes në pjesën e brendshme, të ketë 2 xhepa të brendshëm për fotografi të përmasave 9x12 cm dhe 4x6 cm. Në krahun e djathtë të dosjes, në pjesën e brendshme të ketë xhep me përmasat 30 x 15 cm, (deri ne 5% marzh gabimi).	copë
37	Kalendar tavoline	Kalendar tavoline me kapak të fortë të papërthyeshem me lidhje me spirale, me përmasa 29.8x10.5cm, deri ne 5% marzh gabimi, minimumi 53 fletë, 1 fletë të ketë një javë.	copë
38	Kapak kartoni	Kapak kartoni, format A4, me ngjyra të ndryshme. Pesha 270 gr/M2. Letra të mos jetë e riciklueshme, të qëndroje e rrafshët dhe të mos lëshojë pluhur pas printimit ose fotokopjimit. Pako 100 fletë.	fletë
39	Kapak transparent për lidhje A4	Formati A4, i tejdukshëm. Kapaku të ketë trashësinë minimumi 150 mic. Pako 100 fletë.	fletë
40	Kuti arkive standard	Të ketë përmasa 18x28.5x40.5 cm (5% marzh gabimi), material kartoni i fortë dhe i trashë, me kapak.	fletë
41	Kub shënimesh me ngjitje	Kub shënimesh me ngjitje. Të jetë me ngjitje, përmasa 75x75, ngjyra të ndryshme, jo më pak se 400 fletë.	fletë
42	Blllok shënimesh me ngjitje, 100 fletë	Blllok shënimesh me ngjitje. Përmasa 76x127 mm, ngjyra e verdhë, jo më pak se 100 fletë.	copë
43	Ndarëse për dosje, me shkronja alfabeti A-Z	Ndarëse për dosje, format A4, të ketë të radhitura në rend alfabetik shkronjat nga A-Z, material kartoni, të jenë me ngjyra të ndryshme.	copë
44	Ndarëse letre me 40 fletë	Ndarëse për letër, të jetë në përmasat 50x15 mm, me 4 ngjyra, me 40 fletë secila ngjyrë.	copë
45	Zarfa 30x40 cm	Të jenë material letre, material cilësor përmasat 30x40 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje.	copë
46	Zarfa për CD	Të jenë material letre, ngjyrë e bardhë, mbyllje me ngjitje, të përmbajnë një dritare të qartë për të identifikuar diskun brenda.	copë
47	Zarfa 11x23 cm	Të jenë material letre, me përmasat 11x23 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.	copë
48	Zarfa 19x26 cm	Të jenë material prej letre, me përmasat 19x26 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.	copë
49	Zarfa 23x33 cm (A4)	Të jenë material prej letre. Përmasat 23x33 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.	copë
50	Zarfa format 44x36 cm	Të jenë material letre, përmasat 44x36 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me mbyllje me ngjitje, ngjyre e bardhë.	copë
51	Zarfa plastik me vrima	Material i hollë plastik, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe. Trashësia e zarfave të jetë minimumi 40 micron	copë

## LOTI 2 - BLERJE MATERIALE KANCELARIE TË TJERA ZYRE

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia
1	Bateri 1.5 V të vogla AAA	Bateri 1.5 V të vogla AAA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora etj, afat skadence minimumi 2 vjet.	copë
2	Bateri 1.5 V të vogla AA	Bateri 1.5 V te vogla AA, Alkaline, për përdorim në pulte kondicioneri, pulte televizori, ora, afat skadence minimumi 2 vjet.	copë
3	Bojë vule blu, kuti plastike	Bojë për vulë ngjyrë blu, e përshtatshme për të gjitha llojet e vulave. Bojë ekologjikisht e pastër dhe rezistente. Boja vjen në paketim 30ml. Kutitë plastike.	shishe
4	CD-R min 40x90 800 MB, me kapak	CD-R 800 MB, përmasa standard, çdo CD me kapak. Minimumi kapacitet 800MB/90 minutash dhe shpejtësi regjistrimi deri në 40X për regjistrim. Të sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot.	copë
5	DVD-R, 16 x 4.7GB	Disqet optike sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishëm, ideale për të gjitha fotot dhe videot. Me shpejtësi 16x dhe kapacitet regjistrimi 4.7 GB, deri në dy orë video në një disk DVD-R. Të jetë rezistent ndaj pluhurave dhe ndaj ujit, gjithashtu duhet t'i rezistojnë ndryshimeve në temperaturë dhe lagështi. Të jenë në paketim bobinë me 10 copë. Paketimet duhet të jenë të dobishëm dhe mbrojtëse ndaj prekjeve për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e disqeve.	bobinë
6	USB Flash Drive 16 GB 3.0	Emri i produktit: USB Flash Drive 16 GB 3.0, USB me kapacitet ruajtjes 16GB, Lloji i lidhësit: USB Type A. Prodhi i USB-se (gjenerata): USB 3.0, Kapaciteti i ruajtjes: 16 Gigabyte, i përshtatshëm për sisteme të ndryshme operative, me përmasa dhe forma të ndryshme sipas brandeve që ekzistojnë në treg.	copë
7	USB 3.0, 32GB	USB me kapacitet 32GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.	copë
8	USB 3.0, 64 GB	USB me kapacitet 64GB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të të dhënave.	copë
9	Hard drive i jashtëm 2.5, 2TB, USB 3.0	Hard drive i jashtëm 2.5", kapacitet 2 TB, porta USB 3.0, sigurojnë ruajtje të sigurt dhe afatgjatë të skedarëve dhe dokumenteve të rëndësishme, ideale për të gjitha fotot dhe videot.	copë
10	Evidenciator 4 ngjyra	Të jetë në 4 ngjyra te ndryshme, me maja minimumi 4.5 mm, të mos fshihet.	pako
11	Gërshëre zyre 20-25 cm, dorezë plastike	Gërshëre me dorezë plastike, me përmasa 20-25 cm.	copë
12	Gërshëre zyre 13-17 cm, dorezë plastike	Gërshëre me dorezë plastike, me përmasa 13-17 cm.	copë
13	Goma fshirëse	Të jetë material gome. E përshtatshme për përdorime në zyrë, shkollë etj.	copë
14	Kapse aktesh Nr.3	Për kapje letrash, nr.3, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
15	Kapse aktesh Nr.4	Për kapje letrash, nr.4, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
16	Kapse akt.Nr.5	Për kapje letrash, nr.5, kutia me nga 100 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti

17	Kapse aktesh me veshë 15mm	Kapse me veshë 15 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
18	Kapse aktesh me veshë 19mm	Kapse me veshë 19 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
19	Kapse aktesh me veshë 25mm	Kapse me veshë 25 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
20	Kapse aktesh me veshë 32mm	Kapse me veshë 32 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
21	Kapse aktesh me veshë 41mm	Kapse me veshë 41 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
22	Kapese aktesh me veshë 51mm	Kapse me veshë 51 mm, kutia me nga 12 copë, metalike, e fortë dhe me konstrukt të qëndrueshëm. E përshtatshme për të kapur disa fletë bashkë për një organizim më të mirë të dokumenteve.	kuti
23	Korrektor stilo blister	Korrektor 7 ml (+/-1 ml). Për përdorime të ndryshme, me tharje të shpejtë.	copë
24	Korrektor me furçë	Korrektor me furçë. Për përdorime të ndryshme, me tharje të shpejtë.	copë
25	Kosha zyre metalik	Kosh metalik për letra, 11 litra	copë
26	Hapëse vrimash me 2 vrima 10 fletë	Hapëse vrimash me 2 vrima, material plastik/ metal, të shpojë deri në 10 fletë.	copë
27	Hapëse vrimash me 2 vrima 30-40 fletë	Hapëse vrimash me 2 vrima, material plastik/ metal, të shpojë 30-40 fletë.	copë
28	Hapëse vrimash me 2 vrima, 40-60 fletë	Hapëse vrimash me 2 vrima, material plastik/ metal, me vizore, të shpojë 40-60 fletë	copë
29	Hapëse vrimash me 2 vrima 100 fletë	Hapëse vrimash me 2 vrima, material plastik/metal, me vizore dhe kontenier për pritjen e mbetjeve, të shpoje minimumi 100 fletë.	copë
30	Heqëse teli pincë	Të ketë formën standarde, madhësi normale, me sustë, me siguresë. Të jetë material inoxi, të ketë formën e pincës. Të shërbeje për të hequr telat nga dokumentat pa i dëmtuar.	copë
31	Marker për dërrasë të zezë ose color	Marker për dërrasë e zezë ose të ndryshme, maje minimumi 2 mm.	copë
32	Marker permanent Kuti 4 ngjyrëshe	Marker permanent kuti 4 ngjyrëshe.	pako
33	Marker për CD e zezë ose color	Marker për CD e zezë ose ngjyra të ndryshme, me 2 anë 0.5-1mm.	copë
34	Makinë kapëse minimumi 450 fletë (25 fletë njëherësh)	Makinë për lidhje dokumentesh. Kap 25 fletë njëherësh, të lidhë minimumi 450 fletë. Deri në 500.	copë



35	Makinë heqëse teli e vogël	Heqëse teli flutur, të jetë material metalik, me veshje plastike, të ketë formën standarde, madhësi e vogël, me sustë.	copë
36	Makinë qepje dokumentesh (24/6)	Makinë për qepje dokumentesh, standardi 24/6, të kapë minimumi 25 fletë. Materiali plastik/metal.	copë
37	Makinë qepje dokumentesh (23/20) tavoline	Makinë për qepje dokumentesh, me tela 23/20, të kapë minimumi 180 fletë. Materiali plastik/metal.	copë
38	Mbajtëse kancelarie për mjete	Mbajtëse kancelarie që rrotullohet të ketë minimumi 12 mjete pune, (laps, gome, vizore, gërshërë, stilolaps, thikë për prerje, kapëse aktesh etj.)	copë
39	Mbajtëse dokumentesh horizontale	Të jetë material plastik me ngjyra të ndryshme Të shërbejë për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe të jetë e përshtatshme për zyra.	copë
40	Mbajtëse plastike dokumentesh vertikale	Të jetë material plastik me ngjyra të ndryshme Të shërbejë për të vendosur dokumentat në formë vertikale, për përdorim të përditshëm dhe të jetë e përshtatshme për zyra.	copë
41	Makinë qepëse aktesh 100 fletë	Makinë qepëse aktesh, të kapë minimumi 100 fletë.	copë
42	Makinë qepëse aktesh	Makinë qepëse aktesh, të kapë minimumi 220 fletë.	copë
43	Makinë qepese 24/6	Makinë qepëse aktesh 24/6, material metal + plastike. Të kapë minimumi 25 fletë.	copë
44	Lapsa me gome HB	Laps grafiti me gomë për përdorim të përgjithshëm me fortësi HB. Të jetë pako me 12 copë.	pako
45	Portamina 0.7 mm plastike	Portaminë me strukturë prej materiali plastik rezistent, me majë 0.7 mm.	copë
46	Maja portamine 0.7mm	Maja portamine 0.7 mm, diametri nominal i majës prej plumbi të jetë min 0.7 mm me fortësi HB.	kuti
47	Plastelinë	Plastelinë me pako minimumi 500 gr, lehtësisht e punueshme, ngjyra të ndryshme.	copë
48	Prerëse lapsash plastike me depozitë	Prerëse lapsi, forma katror dhe konike, me depozitë për mbetje, me një fole prerëse.	copë
49	Set tavoline lëkure, minimumi 5 pjesë	Set tavoline, imitacion lëkurë, minimumi të ketë 5 pjesë. Të gjitha pjesët e setit të kenë të njëjtin material, dizajn dhe ngjyrë.	set
50	Sfungjer table magnetike	Fshirëse për tabelë magnetike.	copë
51	Sfungjer për lagie gishti 8cm	Sfungjer për lagie gishti, 8 cm.	copë
52	Ngjitës letre (Stik i bardhë) 21 gr	Ngjitës letre, i bardhë, në formë buzëkuqi, 21 gr (+/- 1 gr). Mos të përmbajë elementë të dëmshëm, i përshtatshëm për letër.	copë
53	Stik i bardhë 40gr	Ngjitës letre, i bardhë, në formë buzëkuqi, 40 gr (+/- 1 gr). Mos të përmbajë elementë të dëmshëm, i përshtatshëm për letër dhe karton	copë
54	Stilolapsa të thjeshtë me kapak	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra të ndryshme.	copë

55	Stilolaps 0.7 mm me ngjyra të ndryshme	Stilo 0.7 mm me ngjyra të ndryshme. Majë metalike gjilpërë 0.7 mm.	copë
56	Stilolaps me xhel blu	Stilolaps me xhel blu, majë 0.7 mm.	copë
57	Stilograf	Stilograf, me hapje, bojë blu, me depozitë.	copë
58	Stilolaps rapid, lantu ose ekuivalenti i tij.	Me majë 0.5mm me kapëse metalike.	copë
59	Stilolapsa me logo	Trup i bardhë ose gri me sustë, me logo sipas kërkesës së AK-së.	copë
60	Stilolaps cilësor për lidhje marrëveshje	Stilolaps me majë 0.7 mm. Me bojë xhel, me ngjyra të ndryshme, me kapak.	copë
61	Shirit ngjitës	Shirit ngjitës, normal, përmasa minimumi 45 mm x 40 m.	copë
62	Shirit ngjitës, letër i bardhë	Shirit ngjitës, letër e bardhë, përmasa minimumi 50 mm x 65 m.	copë
63	Shirit adeziv plastik për ndarëse	Ndarëse PL 45 x 12 mm me 5 ngjyra nga 25 fletë.	copë
64	Shirit ngjitës transparent	Shirit ngjitës, transparent, përmasa minimumi 15mm x 33m.	copë
65	Tabelë portative prezantimi me mekanizëm (70 cm*100 cm)	Tabela të mëdha me fushë të bardhë, me përmasa minimumi 70 cm me 100 cm. Të përshtatshme për të vendosur letër kur është e nevojshme, gjithashtu mund të shkruhet me markera. Me mekanizëm. Mekanizmi lehtësisht i përdorshëm dhe i përshtatshëm për t'u ulur ose ngritur në lartësinë që nevojitet.	copë
66	Tampon vule i mesëm	Ngjyra blu të jetë në kuti metalike, përmasa minimumi 8x12cm.	copë
67	Tampon vule i madh	Ngjyra blu të jetë në kuti metalike, përmasa minimumi 9.5x14.5cm.	copë
68	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	Tela për makina kapëse aktesh 24/6.	kuti
69	Tela për makina kapëse aktesh 23/10	Tela për makina kapëse aktesh 23/10.	kuti
70	Tela Makine 23/20	Tela Makinë 23/20.	kuti
71	Thika të mesme	Thika të mesme, të jetë me prerëse të lëvizshme, me shinë me fiksues, material plastik nga jashtë, të jetë e mprehtë për përdorim për prerje kartoni, fletët transparente etj.	copë
72	Ulluk plastik lidhje 12mm	Të jetë material plastik, gjerësia 12 mm, ngjyra të ndryshme.	copë
73	Ulluk plastik lidhje 15mm	Të jetë material plastik, gjerësia 15 mm, ngjyra të ndryshme.	copë
74	Ulluk plastik lidhje 18mm	Të jetë material plastik, Format A4, gjerësia 18mm, ngjyra të ndryshme.	copë
75	Vinovil minimumi 100-120 gr.	Vinovil minimumi 100 - 120 gr, ngjitës i bardhë, për përdorim të gjerë, dru, PVC, tekstil, qelq, letër, karton etj Mos të përmbajë elementë të dëmshëm.	shishe
76	Vizore 30 cm	Vizore plastike 30 cm, e shkallëzuar në milimetra dhe cm, material plastik i përkulshëm.	copë
77	Vizore plastike 40 cm	Vizore plastike 40 cm, e shkallëzuar në milimetra dhe cm, material plastik i përkulshëm.	copë

### LOTI 3 – BLERJE LETËR

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia
1	Letër fotokopje, 80gr/m2 A4	Përmasa A4 (297mm x 210mm); - Lëmueshmëria 100-150ml/min sipas ISO 8791; - Lagështia 3-4% sipas ISO 287; - Trashësia 109-115 µm sipas ISO 534; - Dukshmëria (Opacity) >94% sipas ISO 2471; - Shkëlqimi 106-115% sipas ISO 247; - CIE Bardhësia 158-175 sipas ISO 11475	risma 500 fletë
2	Letër fotokopje, 80gr/m2 A3	Përmasa A3 (420 mm x 297 mm); - Lëmueshmëria 100-150ml/min sipas ISO 8791; - Lagështia 3-4% sipas ISO 287; - Trashësia 109-115 µm sipas ISO 534; - Dukshmëria (Opacity) >94% sipas ISO 2471; - Shkëlqimi 106-115% sipas ISO 247; - CIE Bardhësia 158-175 sipas ISO 11475	risma 500 fletë
3	Letër fotokopje, 120gr/m2	Letër fotokopje A4, 120gr/m2 me ngjyra të ndryshme	risma 250 fletë
4	Letër fotokopje, 100gr/m2	Letër fotokopje A4, 100gr/m2 ngjyra e bardhë.	risma 500 fletë
5	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra të ndryshme	Letër fotokopje A4, 80gr/m2 me ngjyra të ndryshme	risma 500 fletë
6	Letër fotokopje 160gr/m2	Letër fotokopje A4, 160gr/m2 me ngjyra të ndryshme, pako me 250 fletë.	risma 250 fletë
7	Karton 270 gr	Karton me ngjyra të ndryshme, format A4, 270 gr., Risma me 100 fletë	risma 100 fletë
8	Karton 350 gr	Karton me ngjyra të ndryshme, format A4, 350 gr.	fletë
9	Letër adezive	Letër adezive e bardhë, 70x100cm. Pako 100 fletë.	fletë
10	Etiketa adezive të mëdha	Etiketa adezivite të mëdha, në kuti, kutia me 100 fletë A4.	kuti
11	Fletë transparente fotokopje	Fletë transparente për fotokopje, A4. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët (100 fletë për pako).	pako

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

LOTI 1 – BLERJE MATERIALE KANCELARIE ME BAZË LETRE

Nr.	Emërtimi	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia për Ministrinë e Mbrojtjes	Sasia për Kryeministrinë	Sasia për Ministrinë e Brendshme	Sasia për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Sasia për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Sasia Totale
1	Axhendë ditore afërsisht 14.2x20.5 cm pa logo	Axhenda ditore të ketë përmasat 14.2x20.5 cm (deri në 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, minimumi të ketë 300 faqe, të shkruhet viti aktual.	copë	200					200
2	Axhendë ditore afërsisht 17.2x24 cm, me logo	Axhenda ditore të ketë përmasat 17.2x24 cm (deri në 5% marzh gabimi), minimumi të ketë 300 faqe, ngjyra të ndryshme, të shkruhet viti aktual, me logo. Të jepen përmasat e logos dhe fotoja me ngjyra, dhe kjo e fundit të përcillet në formatin vektorial vetëm tek OE fitues.	copë			200			200
3	Bexho PVC me clip metalik	Bexho PVC me clip metalik dhe me kapëse. Materiali i bexhos të jetë plastik i fortë.	copë			100			100
4	Bllok A4 me kapak, imitacion lëkure	Bllok në format A4 me kapak, imitacion lëkure. Të jetë format A4 me vija ose katrore, të jetë me ngjytje, me kapak imitacion lëkure, ngjyrë gri/e zezë/blu, të ketë 100/120 fletë.	copë	500					500
5	Bllok A4 kapak i fortë me 96 fletë	Bllok format A4, me letër me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, minimumi 96 fletë.	copë			300			300
6	Bllok A4 kapak i fortë me 168 fletë	Bllok format A4, me letër me vija ose kuadrate, kapak i fortë kartoni ngjyra të	copë			100			100

		ndryshme, min 168 fletë.							
7	Bllok shënimesh A5 me 60 fletë	Bllok format A5, me letër me vija ose katrore, kapak i fortë kartoni me ngjyra të ndryshme, minimumi 60 fletë me lidhje spirale.	copë		200				200
8	Bllok A5 imitacion lëkure me 100 fletë	Bllok A5, kapak i fortë imitacion lëkure ngjyra të ndryshme, të ketë minimumi 100 fletë.	copë	300		300			600
9	Bllok shënimesh me material adeziv 75x127 mm	Bllok shënimesh, material adeziv, përmasa 75x127 me ngjitje, (deri në 5% marzh gabimi).	copë			400			400
10	Bllok shënimesh me material adesiv 75 x 75 mm	Bllok shënimesh, materail adesiv, përmasa 75 x 75 mm, (deri ne 5% marzh gabimi).	copë			500			500
11	Çanta kartoni për dhurata, 26x32 cm	Çanta kartoni njëngjyrëshe me dorezë litari për dhurata të përmasave 26x32 cm, kartoni të jetë i fortë (deri ne 5% marzh gabimi).	copë			100			100
12	Çanta kartoni për dhurata, 30x40 cm	Çanta kartoni një ngjyrëshe me dorezë litari për dhurata të përmasave 30x40 cm, kartoni të jetë i fortë me marzh gabimi 5%.	copë			100			100
13	Çanta kartoni për shishe vere, 15x45 cm	Çanta kartoni një ngjyrëshe me dorezë litari për dhurata për shishe verë me përmasa 15x45 cm, kartoni të jetë i fortë (deri ne 5% marzh gabimi).	copë			100			100
14	Dosje firme pa logo	Të jetë me imitacion lëkure, format A4. Të ketë deri në 30 ndarëse për vendosjen e dokumentave A4.	copë	100	10				110

15	Dosje me mekanizëm, 7cm	Dosje me mekanizëm A4, me kuti, përmasa 28x35x7 cm (deri ne 5% marzh gabimi), me ngjyra të ndryshme, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.	copë	900	500	400			<b>1800</b>
16	Dosje me mekanizëm, 5 cm	Dosje me mekanizëm të jetë prej materiali plastik, me trashësi 5 cm, përmasa afërsisht 31x29x5 cm (deri ne 5% marzh gabimi), të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.	copë	900		300			<b>1200</b>
17	Dosje me mekanizëm, 7 cm	Dosje me mekanizëm, material karton i plastifikuar, me trashësi 7 cm. Të ketë të montuar bazamentin metalik për fiksimin e dokumenteve. Me ngjyra të ndryshme. Gjithashtu, të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse.	copë			400			<b>400</b>
18	Dosje me 2 unaza, 2.5 cm	Format A4, materiali karton me mbështjellje të celetonuar, të jetë me 2 unaza. Gjerësia e dosjes të jetë 2.5 cm. (deri ne 5% marzh gabimi)	copë	300					<b>300</b>
19	Dosje plastike (e plastifikuar) me llastik, 3 cm	Dosje plastike me llastik, trashësia të jetë 3 cm, format A4, të ketë nga brenda kapak për fiksimin e materialeve dhe të mbyllet me llastik, me ngjyra të ndryshme.	copë			400			<b>400</b>
20	Dosje kartoni e thjeshtë	Të jetë material kartoni, përmasa 25x34 cm, me veshë në anësore për mbyllje (mbajtjen e dokumentave), gjerësia 9 cm, (deri ne 5% marzh gabimi).	copë			10000	300		<b>10300</b>
21	Dosje arkive kartoni me buton 6 cm	Të jetë karton i trashë, të ketë kapëse (percine) për mbylljen e dosjes, në brendësi	copë				500		<b>500</b>

